



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO  
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Planuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	13-04-2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ./Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMBICK	2078	2022	1/3



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

**A.nr.186/2022**

**Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosijen e Ankesave** i përbërë nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtar si dhe Valentina Kaçandolli Bekteshi-Zyrtare e lartë për bashkëpunim profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën A.nr.186/2022 të datës 28.02.2022 të parashtuar nga ankuesi me adresë Komuna e Fushë Kosovës, kundër vlerësimit të rezultateve në punë për vitin 2021, respektivisht kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “vlerësim i rezultateve të punës”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 12.04.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

**I. ANULOHET** Vlerësimi i rezultateve në punë për vitin 2021 i datës 04.02.2022 për ankuesin

**II. OBLIGOHET** Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit respektivisht Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, duke bërë rivlerësimin e rezultateve të punës për ankuesin për periudhën nga data 01.01.2021 deri me datën 31.12.2021 në pajtim me legjislacionin në fuqi.

**III OBLIGOHET** Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, që ti ndërmarrë veprimet që zbatimi i këtij vendimi të bëhet si në pikën **II** të këtij vendimi.

**IV.** Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

**A r s y e t i m**

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, sipas aktit të emërimit të datës 01.05.2012, është në pozitën “Zyrtar i Projekteve për Rrugë”, i cili me datë 04.02.2022 ka marrë vlerësimin e rezultatit të punës për vitin 2021 nëpërmjet e-mail-it nga Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore.



Ankuesi, kundër vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, me datë 28.02.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokollit 1035/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës komfor dispozitave ligjore në fuqi me datën 07.03.2022 ankesën e ankuesit e ka proceduar për përgjigje në ankesë tek Ministria e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës, ndërsa me datën 14.03.2022, Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë nga Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës me shkresat e bashkëngjitura të lëndës faqe 1/6.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesa e ankuesit e datës 28.02.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Formulari i vlerësimit të rezultatit të punës për vitin 2019 dhe 2021; Kopja e letër njoftimit të ankuesit; Akt emërimi i ankuesit; Vendimi i datës 04.09.2018 për caktim të ushtruesit të detyrës si dhe përgjigja në ankesë nga organi i punësimit me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të bashkëngjitura si nga ankuesi ashtu edhe nga organi i punësimit ka vërtetuar se ekziston baza ligjore për të vendosur, që lënda e ankuesit të kthehet në **rivlerësim, sepse:**

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021, iu është bërë për shkak të shkeljeve të dispozitave ligjore-thelbësore në vlerësim të punës, diskriminim në vlerësimin dhe vlerësim të gabuar i realizimit të objektivave dhe aktiviteteve, shkelje të afateve ligjore të vlerësimit si dhe vlerësim jo real.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të pretendimit ankimor të ankuesit, konkretisht pas analizimit dhe shqyrtimit të provave të lëndës, ka konstatuar se mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i ankuesit me rastin e vlerësimit të rezultateve të punës për vitin 2021, ka vepruar në kundërshtim me nenin 8 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.2 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publikë, i cili përcakton se: **"Vlerësimi përfundimtar i realizimit të objektivave dhe i aftësive profesional të nëpunësit bëhet në fund të periudhës vlerësuese në bazë të një procesi, që përfshin: 1.1 takimi për diskutimin e realizimit të objektivave dhe rezultateve të arritura; 1.vlerësimin (notimi) e objektivave"**, sepse vlerësimi i është dërguar ankuesit në kundërshtim me paragrafin 4 të nenit 8 i kësaj Rregullore, ku përcaktohet se: **"Formulari i vlerësimit siç përcaktohet në paragrafin 3 të këtij neni i dërgohet nëpunësit, i cili diskutohet në një takim me mbikëqyrësin dhe në afat prej 5 dite kalendarike nëpunësi duhet të shprehet (pajtohet ose nuk pajtohet) me vlerësimin e mbikëqyrësit"**, që në rastin konkret organi i punësimit nuk ka dëshmuar me asnjë provë se ankuesi është kontaktuar nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, për të diskutuar lidhur me periudhën e vlerësimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, po ashtu ka shqyrtuar pretendimet e ankuesit i cili ka pretenduar se vlerësimi i rezultateve të punës për vitin 2021 nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë nuk është real dhe nuk është i drejtë dhe ne baze të dëshmive të ofruara ka konstatuar se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit konkretisht Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore me rastin e vlerësimit të ankuesit me notën e përgjithshme 2 tek pjesa e komenteve për asnjë nga objektivat apo aftësitë nuk ka shprehur mendimin se pse është vlerësuar ankuesi me këtë notë, gjegjësisht nuk ka shpjeguar as edhe një koment të vetëm dhe ta jap mendimin lidhur me përmbushjen apo jo të njërës prej objektivave dhe detyrave të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, bazuar në prova dhe fakte të ofruara nga ankuesi dhe organi i punësimit pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit ka vërtetuar se të njëjtat janë pjesërisht të bazuara, andaj eprori aktual është i obliguar që ankuesit ti bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës, në pajtim me nenin 43 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtar Publik, dhe nenin 4 paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, 1.2 pika 1.2.1 deri në 1.2.6 të Rregullores Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike si dhe të ndërmerre të gjitha veprimet me qëllim që vlerësimi i ankuesit të bëhet konformë legjislacionit që rregullon çështjen e vlerësimit të nëpunësve civil.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave obligon Udhëheqësin e drejtpërdrejtë të ankuesit respektivisht Drejtorin e Departamentit të Infrastrukturës Rrugore, që të shqyrtoj të gjitha faktet dhe në bazë të gjeturave të këtij vendimi të bëjë rivlerësimin e rezultateve të punës për vitin 2021 për periudhën 01.01.2021 deri më 31.12.2021 për ankuesin si dhe të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me procedurën e vlerësimit të rezultateve të punës t'i zhvillojnë në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregulloren Nr.21/2020 për Procedurën e Vlerësimit të Rezultateve në Punë të Nëpunësve Civil dhe Nëpunësve të Shërbimeve Publike.

Kolegji si fakt vendimtar lidhur me shqyrtimin e ankesës, mori parasysh edhe faktin notor se viti 2021 ishte vit i përcjellë me situatën e pandemisë me COVID-19, dhe si rezultat i kësaj të gjitha institucionet publike kanë funksionuar me staf esencial dhe reduktime të stafit, rrethana këto që Kolegji vlerëson se kanë ndikuar në përmbushjen e objektivave të punës, andaj Kolegji bazuar në këto rrethana konstaton se Udhëheqësi i drejtpërdrejtë i ankuesit duhet të bëjë rivlerësimin e Rezultateve të punës për vitin 2021, duke marr parasysh të gjitha faktet e cekuar me lartë.


Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi. Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyres për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.186/2022

Valentina Kaçandolli Bekteshi



Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional



### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit,
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit, Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

